VENDIM
Nr. 80, datë 9.6.2016

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "DEVOLL HYDROPOWER" SHA NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC "BANJË", ME FUQI TË INSTALUAR 73,000 kw DHE "MOGLICË", ME FUQI TË INSTALUAR 182, 500 kw DHE FUQI TOTALE TË INSTALUAR 255,500 kw

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa "a" dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", neneve 4, pika 1, germa "a"; 5, pika 1, germa "a"; 13 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 9.6.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Devoll Hydropower" sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie nga HEC "Banjë", me fuqi të instaluar 73,000 kw dhe "Moglicë", me fuqi të instaluar 182,500 kw, me fuqi totale të instaluar 255,500 kw,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Devoll Hydropower" sh.a., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifi-kimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat "a", "b", "c" dhe "d") është plotësuar në mënyrë korrekte. Shoqëria është në proces apelimi të masës gjobë, të vendosur nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
- Dokumentacioni teknik-ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4 dhe 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Devoll Hydropower" sh.a., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Banjë", me fuqi të instaluar 73,000 kw dhe "Moglicë", me fuqi të instaluar 182,500 kw dhe fuqi totale të instaluar 255,500 kw për një afat 30-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti